



EDI RAMA PËRMEND GJYQIN E LIDERËVE TË UÇK-SË NË TAKIMIN
E PARË TË BORDIT TË PAQES NË UASHINGTON

FAQE 4-5

RAMA NË BORDIN E PAQES I KËRKON TRUMPIT TË BËJË DIÇKA PËR LIRIMIN E THAÇIT

- Për hir të Zotit, z. president, le të bëjmë
diçka përpara se, siç thoni ju, gjëra shumë të
këqija të mund të ndodhin sërish



Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në takimin e parë të Bordit të Paqes mbajtur në Uashington, i është lutur presidentit amerikan, Donald Trump, të "bëjë diçka" për ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, i cili gjendet në paraburgim në Hagë së bashku me Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin. Rama ka thënë se "presidenti i Kosovës ka kaluar

gjashtë vjet në një paraburgim nga një gjykatë e posaçme në Hagë, e sponsorizuar nga një sërë shtetesh demokratike, disa prej tyre të pranishme këtu e që duhet t'u vijë turp nga ajo lloj drejtësie ndërkombëtare". "Për hir të Zotit, z. President, le të bëjmë diçka përpara se, siç thoni ju, gjëra shumë të këqija të mund të ndodhin sërish", ka thënë Rama

AKTUALE



PENTAGONI: NUK KA NDRYSHIME
NË DISLOKIMIN E FORCAVE
AMERIKANE

F. 3

FAMILJA SHOIPTARE NË JUG TË
SERBISË, NË SHËNJESTËR TË NJË
FUSHATE PËRNDJEKËSE

F. 6

MINISTRIA E MBROJTJES SHPALL
KONKURS PËR REKRUTIMIN E 320
USHTARËVE TË RINJ NË FSK

F. 7

EKONOMI



KURTI: LIGJI PËR BYRONË
SHTETËRORE DHE AI PËR ÇMIMET
TAVAN, PRIORITETE TË QEVERISË

F. 8

INFLACION AGRESIV NË KOSOVË,
NORMA VJETORE NË JANAR
ARRITI 5.8 PËR QIND

F. 8

SPORT



HIDHET SHORTI PËR ÇEREKFINALET
E KUPËS SË KOSOVËS, DUELE DIREKTE
DHE SFIDA PA FAVORIT TË QARTË

F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

DIPLOMACI APO KONFLIKT SHBA - IRAN? GJASAT JANË “50-50”, SIPAS EKSPERTËVE

WASHINGTON, 20 SHKURT - Pasi bisedimet bërthamore ShBA - Iran kanë përfunduar në Gjenevë me tryzni të fortë amerikane ndaj Teheranit për ta kufizuar veprimtarinë bërthamore, ekspertë të njohur në Uashington kanë thënë se kriza tani ndodhet në një pikë kthese dhe se gjasat për paqe ose luftë janë “50-50”. Bisedimet kanë përfunduar më 18 shkurt pa ndonjë përparim vendimtar. Shtëpia e Bardhë ka thënë se palët mbeten “shumë larg njëra-tjetrës”, pavarësisht asaj që e ka përshkruar si përparim të kufizuar. Sekretarja e shtypit, Karoline Leavitt, u ka thënë gazetarëve se Irani pritet të kthehet me më shumë hollësi “në javët e ardhshme”. Para takimit në Gjenevë, Teherani ka zhvilluar stërvitje ushtarake, duke lëshuar raketa drejt Ngushticës së Hormuzit, e cila është një nga korridoret më jetike të transportit të naftës në botë. Ai ka vazhduar më 19 shkurt me stërvitje të përbashkëta detare me Rusinë. Pentagoni ka grumbulluar forca të mëdha ushtarake në rajon. Aeroplanmbajtësja “USS Abraham Lincoln”, e pajisur me avionë luftarakë “F/A-18” dhe “F-35”, po vepron në ujërat përreth. Raketahedhës, përfshirë “USS Mitscher” dhe “USS

Michael Murphy”, janë vendosur në Gjirin Persik. Teherani po vazhdon ta sfidojë trysinë me të cilën po përballët për programin e tij bërthamor dhe pasurimin e uranimit, duke këmbëngulur se ai është kryekëput për qëllime civile dhe duke mohuar çdo përpjekje për të ndërtuar armë bërthamore. Besohet se Irani nuk e ka ndonjë program aktiv për armë bërthamore, megjithëse e ka një histori aktivitetesh kërkimore për armë atomike. Duke folur në Qendrën për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare (CSIS) më 18 shkurt, katër ish-zyrtarë amerikanë me përvojë të gjatë në çështjet e Lindjes së Mesme e kanë vlerësuar gjendjen drejtpërdrejt. Michael Ratney, ish-i dërguar special i ShBA-së për Sirinë dhe ambasador në Arabinë Saudite (2023-2025), i pyetur nëse rajoni po shkon drejt luftës apo paqes, ka thënë: “Mendoj se është 50-50”. Ratney ka thënë se secila marrëveshje mund të mos i ngjajë një akordi gjithëpërfshirës bërthamor. Përkundrazi, ajo mund të jetë kornizë, njoftim ose proces ndërtimi besimi që i lejon Trumpit të pretendojë se ka sjellë stabilitet, edhe nëse çështjet thelbësore mbeten të



pazgjidhura. Joseph Farsakh, ish-zyrtar i Departamentit të Thesarit të ShBA-së që ka punuar mbi politikën e sanksioneve për Lindjen e Mesme, ka thënë gjithashtu se, edhe nëse bisedimet përfundimisht japin rezultate, një marrëveshje gjithëpërfshirëse duket e pamundur në klimën e tanishme të mosbesimit. Një rezultat më i mundshëm, ka thënë ai, do të ishte një marrëveshje e pjesshme që ofron lehtësim të kufizuar të sanksioneve, duke shtyrë çështjet më të debatueshme për më vonë. Një marrëveshje e tillë mund t'i rrisë ndjeshëm eksportet iraniane të naftës, duke i çuar potencialisht ato në rreth 2.5 milionë fuçi në ditë dhe duke futur naftë me vlerë midis 50 miliardë dhe 90 miliardë dollarëve në vit në

tregjet globale. Në një skenar “ideal”, stabiliteti më i madh mund të çlirojë atë që ai e përshkroi si një dividend paqeje, duke nxitur investime nga jashtë dhe integrim më të gjerë rajonal. Por, Farsakh ka paralajmëruar se një fluks i shpejtë i naftës së papërpunuar iraniane mund t'i ulë çmimet globale të naftës, duke i vënë nën tryzni shtetet e Gjirit që mbështeten në çmime më të larta për të financuar programe ambicioze të transformimit ekonomik. Dhe, edhe me një marrëveshje, ka thënë ai, nuk është i bindur se rreziku i goditjeve të ardhshme nga ShBA-ja, ose ndoshta nga Izraeli, do të zhdukej plotësisht. Vali Nasr, ish-këshilltar i lartë në Departamentin e Shtetit, gjithashtu e ka përshkruar gjendjen si të ndarë në mënyrë

të barabartë. As Uashingtoni dhe as Teherani nuk duan vërtet luftë të rrëmujshme, ka argumentuar ai, duke pasur parasysh rreziqet e mëdha që bart. Ky hezitim i përbashkët mund t'i shpëtojë përfundimisht të dyja palët nga gremina. Në të njëjtën kohë, Nasr ka theksuar se llogaritja politike personale e Trumpit do të jetë vendimtare. Analiza tradicionale e politikës së jashtme, e përqendruar te institucionet dhe interesat afatgjata, mund të jetë më pak parashikuese në këtë rast. Nasr ka theksuar gjithashtu se disa kriza globale po zhvillohen njëkohësisht, që do të thotë se zhvillimet diku tjetër mund ta riformësojnë shpejt vendimmarrjen për Iranin. Ndërsa Susan Ziadeh, ish-zëvendësndihmësekretare e Shtetit për çështjet e Lindjes së Afër, ka paralajmëruar se vetë grumbullimi ushtarak krijon vull. Me një prani kaq të madhe detare dhe ajrore tashmë në vend, ka sugjeruar ajo, mund të mos jetë e lehtë që thjesht të tërhiqen. Me anije luftarake të vendosura pranë ujërave iraniane, raketa të lëshuara gjatë stërvitjeve ushtarake dhe liderë në të dyja anët që lëshojnë paralajmërime të ashpra, hapësira për keqllogaritje është gjithashtu e kufizuar.

POLONIA LARGOHET NGA KONVENTA E OTAVËS, PËRGATITET TA MINOJË KUFIRIN ME RUSINË

VARSHAVË, 20 SHKURT - Kryeministri polak Donald Tusk ka deklaruar se Varshava së shpejti do të jetë në gjendje të minojë kufijtë e saj lindorë me Rusinë, ndërsa vendi doli zyrtarisht të premten nga Konventa e Otavës që ndalon përdorimin e minave tokësore. Tusk ka prezantuar “Bluszc” ose “Ivy”, një shtresë minash e projektuar për fshehtësi dhe autonomi, të cilën Polonia planifikon ta debutojë ndërsa rrit aftësitë e saj në krahun lindor. “Sot, patë një prezantim të shkurtër të aftësive të sistemit Bluszc. Jemi në proces të finalizimit të këtij projekti brenda

East Shield, i cili është thelbësor për sigurinë tonë, territorin tonë dhe kufirin tonë. Kjo përfshin edhe aftësinë që do të arrijmë së shpejti aftësinë për të minuar kufirin polak në rast kërcënimi brenda 48 orëve”, ka thënë Tusk. Varshava i është bashkuar Finlandës, Ukrainës dhe tre vendeve baltike, Estonisë, Letonisë dhe Lituanisë për të njoftuar se do të tërhiqej zyrtarisht nga konventa ndërkombëtare në gusht të vitit të kaluar, duke përmendur nevojën për të përdorur mina tokësore për të



forcuar mbrojtjen e tyre kufitare. Ata kanë frikë se vendet e tyre mund të jenë në shënjestër të radhës nga Rusia, e cila nuk e ka nënshkruar kurrë traktatin, pasi lufta e saj e vazhdueshme në Ukrainë nuk tregon shenja zbehjeje. Ky veprim është

kritikuar pasi shumë njerëz kanë mbetur të shqetësuar për rikthimin të minat tokësore, të cilat historikisht kanë qenë jashtëzakonisht të dëmshme për civilët. Minat kundër personelit njihen për shkaktimin e viktimitave të konsiderueshme civile në vendet pas konfliktit si Kamboxhia, Angola dhe Bosnja dhe Hercegovina. Konventa e Otavës, e nënshkruar në vitin 1997 për të mbrojtur civilët, mbulon vetëm minat kundër personelit, që do të thotë se lloje të tjera si minat antitank, të cilat kërkojnë një peshë më të

rëndë për t'u aktivizuar, lejohen sipas marrëveshjes. Gati tre duzina vendesh nuk janë anëtarësuar kurrë në konventë, duke përfshirë disa prodhues dhe përdorues kryesorë aktualë dhe të mëparshëm të minave tokësore, si ShBA-të, Kina, India, Pakistani, Koreja e Jugut dhe Rusia. Polonia kishte ratifikuar Konventën e Otavës në vitin 2012 dhe ka përfunduar shkatërrimin e rezervave të saj të minave kundër personelit në vitin 2016. Por, udhëheqësit e saj politikë kanë folur për rifillimin e prodhimit vendas sapo vendi të dalë zyrtarisht nga traktati i Otavës.

Suedia e ndihmon Ukrainën me një paketë ushtarake në vlerë prej 1.2 miliard eurosh

STOKHOLM, 20 SHKURT - Qeveria suedeze ka miratuar një paketë të re ndihme ushtarake për Ukrainën me vlerë rreth 1.2 miliard euro, duke e fokusuar në forcimin e mbrojtjes ajrore të vendit të goditur nga lufta. Sipas njoftimeve zyrtare, kjo është paketa e 21-të e ndihmës së Suedisë për Ukrainën që nga

fillimi i konfliktit dhe përfshin sisteme raketore dhe pajisje të tjera të avancuara mbrojtëse, raporton “Reuters”. Sistemi ajror “Tridon Mk2” është pjesa kryesore e paketës, i njohur për efikasitetin e tij kundër dronëve dhe kërcënimeve ajrore. Rreth 400 milionë euro do të përdoren për blerjen e

sistemeve Tridon Mk2, sensorëve, robotëve dhe topave kundër ajrorëve. 524 milionë euro do të mbështesin prodhimin ukrainas të raketave me reze të gjatë dhe dronëve, ndërsa 280 milionë euro të tjera do të shkojnë për minobazë, artileri, pjesë rezervë dhe trajnime për personelin

ukrainas. Zyrtarët suedezë theksuan se ky paketim ka për qëllim të forcojë kapacitetin mbrojtës të Ukrainës dhe të ndihmojë vendin në mbrojtjen e popullsisë dhe territorit të saj nga sulmet ajrore. Ky vendim i Suedisë pasqyron përpjekjet e vazhdueshme të vendeve perëndimore për të



mbështetur Ukrainën në luftën e saj kundër agresionit rus.

Themelohet Këshilli për shënimin e 28-vjetorit të “Epopesë së UÇK”-së

PRISHTINË, 20 SHKURT - Qeveria e Kosovës ka themeluar Këshillin Shtetëror për shënimin e 28-vjetorit të “Epopesë së UÇK”-së. Kryesues i këtij këshilli është emëruar ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ministri Andin Hoti, bashkëryesues ndërsa anëtarë: Sami Lushtaku, Saranda Bogujevci, Elbert Krasniqi, Bashkim Jashari dhe Gazmend Hoxha. Në mbledhjen e qeverisë është bërë me dije se janë në pritje edhe të një anëtarë nga organizatat e dala nga lufta e

UÇK-së, presidenca, kryeministria dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës. Në adresimin e tij, kryeministri Albin Kurti ka thënë se pa 5, 6 dhe 7 marsin nuk do të bëhej 17 shkurti dhe pa flijimin e familjes Jashari nuk do të bëhej festa shtetërore e Republikës. “Shkurti është muaj feste shtetërore dhe krenarie qytetare. Marsi është muaj lavdie historike dhe nderim i sakrificës. Në kalendar vjetor shkurti vjen para marsit, por në kalendarin e historisë sonë,



para shkurtit ishte marsi. E pa 5, 6 dhe 7 marsin nuk bëhej 17 shkurti. Pa flijimin e familjes

Jashari nuk bëhej festa shtetërore e Republikës. E pa luftën e Ushtrisë Çlirimtare të

Kosovës për liri nuk bëhej parakalimi i ushtrisë sonë në liri”, ka thënë Kurti. Kurti ka thënë se “Epopeja e UÇK”-së është momenti i sakrificës, guximit dhe besimit në liri. “Epopeja e UÇK-së përfaqëson momentin kur sakrifica, besimi dhe guximi në liri u bënë një me fatin e popullit tonë. Qëndresa heroike e familjes Jashari dhe e luftëtarëve të UÇK-së u shndërrua në frymëzim për një popull të tërë që kërkonte shtet dhe etnitet”, ka deklaruar Kurti.

PENTAGONI: NUK KA NDRYSHIME NË DISLOKIMIN E FORCAVE AMERIKANE

PRISHTINË, 20 SHKURT - Një zyrtar i Departamentit Amerikan të Mbrojtjes ka thënë se aktualisht nuk ka ndonjë ndryshim në dislokimin e forcave amerikane. “Sot nuk kemi për të njoftuar ndonjë ndryshim në dislokimin e forcave”, ka thënë ai në një përgjigje me shkrim për “REL”-in. Përgjigjja nga Departamenti Amerikan i Mbrojtjes, pasi gazeta amerikane “Politico”, duke cituar katër diplomatë të NATO-s, ka raportuar se Shtetet e Bashkuara të Amerikës po kërkojnë nga aleanca ta shkurtojë aktivitetin e saj të jashtëm, përfshirë atë në misionin paqeruajtës në Kosovë - KFOR. Në përgjigjet për “REL”-in, një zyrtar i NATO-s ka thënë se Shtetet e Bashkuara luajnë rol thelbësor në mbështetje të sigurisë së qëndrueshme në Kosovë dhe për stabilitetin rajonal. Megjithatë, ai ka theksuar se autoritetet amerikane janë adresa për më shumë hollësi. Ai ka thënë se ShBA-ja aktualisht i ka rreth 600 trupa të angazhuara në misionin e KFOR-it dhe se e ka udhëheqjen e Komandës Rajonale Lindje. Komanda



Rajonale Lindje kontribuon në aktivitetet e përditshme të KFOR-it në mënyra të ndryshme, duke përfshirë

patrullimet, ushtrimet, angazhimet me përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve lokale dhe mbështetjen e projekteve

të rindërtimit dhe zhvillimit ekonomik. “REL”-i ka kërkuar komente në lidhje me raportimet e “Politico”-s edhe nga Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Mbrojtjes, dhe është në pritje të përgjigjeve.

Çfarë thuhet në artikullin e “Politico”-s?

Sipas “Politico”-s, në muajt e fundit Uashingtoni ka lobuar për reduktimin e operacionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR, që të përfundojë misionin në Irak dhe që aleatët nga Indo-Paqësori të mos marrin pjesë në samitin vjetor të aleancës që mbahet në Ankara të Turqisë në korrik. Ky raportim vjen pasi vitin e kaluar ishin ngritur shqetësime në mesin e shteteve evropiane se ShBA-ja mund t'i tërhiqte plotësisht trupat e saj nga Evropa. Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Pete Hegseth, atëbotë kishte porositur Evropën se duhej të përgatitej për një rishikim dhe reduktim eventual të pranisë ushtarake amerikane. Megjithatë, tërheqje të plotë nuk pati, e në tetor ShBA-ja ka njoftuar për tërheqjen e disa trupave nga Rumania. Kjo

tërheqje u tha se ishte pjesë e një strategjie më të gjerë të ShBA-së që të përqendrohet në Indo-Paqësor. ShBA-ja ka 590 trupa në Kosovë në kuadër të misionit paqeruajtës të KFOR-it. Nga afër 50 mijë trupa sa ishin dislokuar më 1999, pas përfundimit të luftës, në Kosovë aktualisht janë 4 767 trupa paqeruajtëse të KFOR-it nga 33 shtete të ndryshme. Kampi “Bondsteel”, që gjendet pranë Ferizajt, shërben si baza më e madhe ushtarake e ShBA-së në Ballkan. Kosova e konsideron qenësore aleancën me Shtetet e Bashkuara, vend që ka kontribuar në pavarësinë dhe shtetndërtimin e saj. Ndryshe, KFOR-i është reaguesi i tretë i sigurisë në Kosovë, pas Policisë së Kosovës dhe misionit të Bashkimit Evropian për sundim të ligjit, EULEX. Ky mision paqeruajtës i NATO-s, veç të tjerash, është përgjegjës për sigurinë në vijën kufitare mes Kosovës dhe Serbisë. Shënim: Presidenti amerikan Donald Trump e ka nënshkruar një urdhër ekzekutiv në shtator të vitit 2025, duke e ndryshuar emrin e Departamentit të Mbrojtjes në Departament të Luftës, si emër të dytë.

Qeveria miraton sanksione shtesë kundër Rusisë dhe Bjellorusisë

PRISHTINË, 20 SHKURT - Me propozim të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD), Qeveria e Kosovës ka miratuar pakon e 19 të masave kundër Federatës Ruse dhe Bjellorusisë në raport me luftën në Ukrainë. Në fund të shtatorit të vitit të kaluar ishin miratuar 18 pako të tjera si masë kundër këtyre shteteve. Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i MPJD-së, Glauk Konjufca, ka thënë se sanksionet janë në linjë me Shtetet e Bashkuara të

Amerikës (ShBA) dhe Bashkimin Evropian (BE). Ai ka potencuar se Kosova synon promovimin e paqes, demokracisë dhe lirinë e njeriut. “Pakoja synon sektorin e energjisë, financave, kompleksin ushtarako-industrial, tregtinë dhe zinxhirët e furnizimit me mallra ushtarake, shërbimet strategjike përfshirë teknologjinë dhe inteligjencën artificiale dhe ndërmerr masa lidhur me kontrollin e lëvizjes së diplomatëve rusë dhe



përgjegjësinë për rrëmbimin dhe deportimin e fëmijëve ukrainas. Masat janë edhe

kundër Bjellorusisë”, ka thënë Konjufca. Me këtë paketë numri i anijeve

të listuara në flotën në “hije” të Rusisë arrin në gjithsej 557. Kosova është rreshtuar përkrah Përfundimit menjëherë pasi Rusia e kishte nisur pushtimin e plotë të Ukrainës në shkurt 2022 e prej atëherë i ka miratuar pakot e BE-së dhe ShBA-së kundër Moskës. Kjo luftë, e cila po vazhdon, sipas Kombeve të Bashkuara, ua mori jetën mbi 10 mijë civilëve në Ukrainë. Të paktën 40 për qind e popullsisë kanë nevojë për një lloj të ndihmës humanitare.



EDI RAMA PËRMEND GJYQIN E LIDERËVE TË UÇK-së NË TAKIMIN
E PARË TË BORDIT TË PAQES NË UASHINGTON

RAMA NË BORDIN E PAQES I KËRKON TRUMPIT TË BËJË DIÇKA PËR LIRIMIN E THAÇIT

- Për hir të Zotit, z. president, le të bëjmë diçka përpara se, siç thoni ju, gjëra shumë të këqija të mund të ndodhin sërish

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në takimin e parë të Bordit të Paqes mbajtur në Uashington, i është lutur presidentit amerikan, Donald Trump, të “bëjë diçka” për ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, i cili gjendet në paraburgim në Hagë së bashku me Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin. Rama ka thënë se “presidenti i Kosovës ka kaluar gjashtë vjet në një paraburgim nga një gjykatë e posaçme në Hagë, e sponsorizuar nga një sërë shtetesh demokratike, disa prej tyre të pranishme këtu e që duhet t’u vijë turp nga ajo lloj drejtësie ndërkombëtare”. “Për hir të Zotit, z. President, le të bëjmë diçka përpara se, siç thoni ju, gjëra shumë të këqija të mund të ndodhin sërish”, ka thënë Rama

vendit tim, ku udhëheqja e presidentit Trump gjatë mandatit të tij të parë, i solli Kosovën dhe Serbinë më pranë se kurrë drejt një marrëveshjeje përfundimtare paqeje. Presidenti i Kosovës, që asokohe u ndalua të udhëtonte drejt Shtëpisë së Bardhë në mënyrë brutale për të nënshkruar atë marrëveshje, në praninë e presidentit Trump dhe, në fakt, kjo ishte çfarë u bë nga ai prokuror sikur që përdoqi edhe vetë presidentin Trump dhe për këtë u bë i famshëm botërisht”, ka thënë Rama.

Rama i ka thënë Trumpit një “prokuror i financuar nga ky vend i madh e tatimpaguesit e tij, kërkoi 45 vjet burgim për të, një kërkesë që shkaktoi një valë tronditëse poshtërimi në të gjithë tërësinë e një vendi paqedashës”. “Sot presidenti i Kosovës ka kaluar gjashtë vjet në një paraburgim nga një gjykatë e posaçme në Hagë, e sponsorizuar nga një sërë shtetesh demokratike, disa prej tyre të pranishme këtu dhe që duhet t’u vijë turp nga ajo lloj drejtësie ndërkombëtare. Vetëm javën e kaluar, zoti president, një tjetër prokuror i financuar nga ky vend i madh e tatimpaguesit e tij, kërkoi 45 vjet burgim për të, një kërkesë që shkaktoi një valë tronditëse poshtërimi në të gjithë tërësinë e një vendi paqedashës”, ka thënë Rama. Krejt në fund të fjalës së tij, Rama i është drejtuar Trumpit me këto fjalë: “Për hir të Zotit, z. president, le të bëjmë diçka përpara se, siç thoni ju, gjëra shumë të këqija të mund të ndodhin sërish”. “Dhe në këtë moment ka vetëm disa muaj që qëndrojnë midis një njeriu, i cili u ngrit nga qëndresa ndaj

EPOKA E RE

Lirim GECI

UASHINGTON, 20 SHKURT - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama dhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, kanë marrë pjesë në takimin e parë të Bordit të Paqes në Uashington, i cili është drejtuar nga presidenti i ShBA-së, Donald Trump. Kryeministri Rama gjatë fjalimit në takimin e Bordit të Paqes ka kërkuar në mënyrë eksplicite nga presidenti Trump të bëjë diçka për ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, i cili gjendet në paraburgim në Hagë që nga nëntori i vitit 2020 dhe është duke u ballafaquar me një kërkesë të prokurorisë për

dënim prej 45 vjetëve burgim. Ish-drejtuesit e UÇK-së, Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, janë duke u akuzuar kinse për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, për të cilat të katërtit janë deklaruar të pafajshëm. Gjyqi ndaj tyre në Gjykatën Speciale të Kosovës në Hagë ka përfunduar më 18 shkurt dhe gjykatësit pritet ta marrin një vendim në muajt në vijim. Rama para të pranishmeve në takimin e Bordit të Paqes ia ka kujtuar Trumpit se Thaçi ishte ndaluar të shkonte në Shtëpinë e Bardhë për nënshkrimin e marrëveshjes përfundimtare me Serbinë, pasi Jack Smith kishte ngritur aktakuzë ndaj tij,

Veselit, Selimit dhe Krasniqit. “Më lejoni shumë shkurtimeisht t’ju tërheq vëmendjen te një tjetër konflikt i hapur, më pranë



spastrimit etnik për t’u shndërruar në një paqebërës dhe një rezultati shkatërrimtar nga një gjykatë që deri tani ka dështuar, në çdo hap t’u përmbahet standardeve të drejtësisë demokratike”, ka thënë Rama.

Paraprakisht kryeministri Rama ka folur edhe për Bordin e Paqes. Ai ka thënë se “vota plotësisht e harmonizuar dypartiake që parlamenti ynë pati në mbështetje të kësaj nisme, flet vetë për sa e nderuar ndihet Shqipëria që është një prej anëtareve themeluese e kësaj organizate të re”. “Shumë thonë se Bordi i Paqes synon t’i zëvendësojë Kombet e Bashkuara, por mua nuk më duket si një përpjekje për ta zëvendësuar OKB-në, por nëse ndihmon ta shkundë atë gjigand në agoni dhe, dashtë Zoti, ta zgjojë, atëherë Zoti e bekoftë Bordin e Paqes”, ka thënë Rama, duke e përgëzuar Trumpin për rolin vendimtar për ta ndalur konfliktin pikëllues në Gazë “Z. President, ne përgëzojmë rolin tuaj vendimtar për ta ndalur konfliktin pikëllues në Gazë dhe Shqipëria ka konfirmuar pjesëmarrjen e saj në forcën e stabilizimit me trupat e saj. Në të njëjtën kohë, propozoj që ky Bord t’i ftojë të gjitha vendet të kontribuojnë drejtpërdrejt për ndërtimin e një objekti publik të dedikuar për fëmijët palestinezë. Duke bërë kështu, bota do t’i ndihmonte fëmijët e Gazës që janë pengjet më të pafajshme të lunatizmit të Hamasit, të rriteshin me praninë fizike të vargut më të madh të duarve që ka shtrënguar bashkë njerëzimi ndonjëherë, jo vetëm duke vendosur paratë, por po kështu duke sjellë dhe arkitektët

e tyre në mënyrë që bota të transformojë një plagë të historisë në një oazë shprese, ku dhembshuria merr formë konkrete dhe e ardhmja merr formë rreth atyre që meritojnë më shumë, brezi i ardhshëm i palestinezëve. Shqipëria do të ishte e privilegjuar të bëhej pjesë e këtij vargu”, ka thënë Rama, duke shtuar se Shqipëria është mike e afërt me Izraelin dhe vendet arabe. “Shpresojmë fort të jemi një vlerë e shtuar e vizionit tuaj të jashtëzakonshëm”, ka thënë Rama.

Trumpi: Aleatët kanë kontribuar mbi 7 miliardë dollarë për Gazën, Kosova e gatshme

Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka thënë se vendet aleate kanë kontribuar me 7 miliardë dollarë për ta ndihmuar Gazën, ndërsa Kosova është zotuar për të ndihmuar me trupa ushtarake përmes Bordit të Paqes. Duke folur në takimin e parë të Bordit të Paqes në Uashington, Trumpi ka thënë se pesë vende, përfshirë Kosovën dhe Shqipërinë, janë zotuar se do të dërgojnë trupa në forcën ndërkombëtare të sigurisë në Gazë.

Trumpi ka njoftuar se Shtetet e Bashkuara do të kontribuojnë me 10 miliardë dollarë. Në takimin inaugurues të Bordit të Paqes ka marrë pjesë edhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, pasi Kosova është ndër anëtarët themeluese.

Bordi i Paqes me 27 anëtarë është themeluar më 22 janar në Davos të Zvicrës, në prani të



Trumpi, Osmanit: Nëse nuk shkoni mirë me Serbinë, më telefononi

Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, ka thënë se ka ndihmuar në zgjidhjen e tensioneve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ai e ka vlerësuar presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, duke i thënë se është duke bërë punë të shkëlqyer. “Kosova dhe Serbia, ju e arritët këtë. Punë e shkëlqyer! Faleminderit shumë! E vlerësojmë shumë”, ka thënë Trumpi, duke ftuar Osmanin

të ngrihet në këmbë për ta përshëndetur. Ai ka thënë se ndihet i kënaqur që Kosova dhe Serbia, sipas tij, po shkojnë mirë me njëra-tjetrën, duke apeluar tek Osmani që ta kontaktojë në rast se situata në mes të dy shteteve ndryshon. “Ju po shkoni mirë me njëri-tjetrin dhe, kur nuk shkoni mirë, më telefononi dhe ne e zgjidhim”, është

shprehur Trumpi. Nga ana tjetër, Osmani i është përgjigjur Trumpit duke i thënë: “Do t’ju telefonojmë”. Presidentja Osmani e ka falënderuar presidentin Trump, derisa ka thënë se Kosova ndjeu peshën e garancisë amerikane. “Kosova sot ndjeu peshën e garancisë amerikane! Faleminderit, President Trump!”, ka shkruar Osmani në “Facebook”.

presidentit Trump. Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara e ka autorizuar këtë trup që ta mbikëqyrë zbatimin e armëpushimit në Gazë dhe të angazhohet në aspektin e qeverisjes dhe rindërtimit. Themelimi i Bordit është paraparë në planin 20-pikësh të

Trumpit për paqe në Gazë. Ky plan është pranuar tetorin e kaluar nga Izraeli dhe Hamasi, organizatë e shpallur terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe fuqitë e tjera, për t’u dhënë fund luftimeve dyvjeçare.

Kontributi i Kosovës

Presidenca e Kosovës ka konfirmuar më herët se nuk i është kërkuar pagesa prej 1 miliard dollarësh për Bordin e Paqes. Thuhet se për t’u bërë anëtar i përhershëm, një vend duhet ta paguajë një shumë prej një miliard dollarësh. Ndërkohë, më herët, autoritetet në Kosovë kanë konfirmuar se janë në proces të shqyrtimit të formës dhe kapacitetit me të cilin do të mund të kontribuojnë pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në Forcën Ndërkombëtare Stabilizuese për Gazën.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka treguar se pjesëmarrja e FSK-së në këtë forcë vjen pas pjesëmarrjes në një konferencë në Doha të Katarit në dhjetorin e vitit paraprak, të organizuar nga Komanda Qendrore e

Shteteve të Bashkuara. Ndërkohë, komandanti i Forcës Ndërkombëtare Stabilizuese, gjeneralmajori amerikan Jasper Jeffer, ka dhënë më shumë hollësi gjatë takimit të Bordit për këtë forcë. “Pesë vendet e para kanë angazhuar trupa për të shërbyer në Forcën Ndërkombëtare Stabilizuese (ISF) – Indonezia, Maroku, Kazakistani, Kosova dhe Shqipëria. Dy vende kanë marrë përsipër të trajnojnë policinë – Egjipti dhe Jordania”, ka thënë Jeffers.

Jeffers ka thënë se ISF do të nisë dislokimin në Rafah, në jug të Gazës, ku do ta trajnojë policinë atje dhe më pas do të “zgjerohet sektor pas sektori”. Plani afatgjatë, sipas Jeffers, është të përdoren 20 mijë trupa të ISF-së dhe të trajnohen 12 mijë policë. Lufta mes Izraelit dhe Hamasit ka nisur në tetor të vitit 2023, pasi Hamasi ka vrarë mbi 1 200 njerëz në Izrael dhe ka marrë qindra pengje. Sulmet hakmarrëse izraelite në Gazë kanë shkaktuar mbi 60 000 njerëz të vrarë, krizë urie dhe dëme të mëdha infrastrukturore.



Dështon rezoluta në Komision për liderët e UÇK-së, deputetët maqedonas bojkotojnë mbledhjen

SHKUP, 20 SHKURT - Në Komisionin për Politikë të Jashtme në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut ka dështuar miratimi i propozim-rezolutës për respektimin e standardeve të procedurave penale kundër krerëve të

UÇK-së. Mbledhja ka dështuar në mungesë të kuorumit, respektivisht deputetët maqedonas nga VMRO-ja dhe LSDM-ja bojkotuan seancën. “Mungesa e deputetëve, anëtarëve të tjerë, është e qëllimshme për ta sabotuar

mundësinë e punës së komisionit me të vetmin qëllim që kjo pikë të mos vijë në rend debati”, ka thënë Skënder Rexhepi nga Fronti Evropian. Ndërsa Ilire Dauti ka thënë se “meqenëse sjellja e kolegëve

tanë këtu maqedonas duhet të jetë në këtë formë, pra neve na mbetet të bashkangjitemi në rezolutat e Shqipërisë dhe Kosovës. Është e papranueshme për mua sjellja në këtë formë”. Meqë rezoluta nuk ka kaluar



filtrin e komisionit, nuk do të shkojë as në seancë plenare dhe me shumë gjasë nuk do të miratohet.

FAMILJA SHQIPTARE NË JUG TË SERBISË, NË SHËNJESTËR TË NJË FUSHATE PËRNDJEKËSE



SURDULLICË, 20 SHKURT - Kordonë policie para furrave të bukës, protesta dhe gjuhë e urrejtjes, kjo është çfarë tregojnë pamjet nga Surdullica në jug të Serbisë. Në rrugët e këtij qyteti të vogël, i cili ka rreth 10 mijë banorë, një pjesë e qytetarëve ditët e fundit po protestojnë për shkak të vdekjes së një bashkëqytetari në një aksident trafiku, e cila ngjalli tensione etnike, pasi i dyshuari për aksidentin është një i ri me kombësi shqiptare. Edhe pse i dyshuari është arrestuar, në protesta janë parë pankarta që bënin thirrje për bojkotimin e furrave të bukës në pronësi të familjes së të dyshuarit, si dhe janë dëgjuar thirrje për dëbimin e gjithë familjes shqiptare. Edhe në protestën e 19 shkurtit pati mesazhe të ngjashme. Goran Mlladenoviq, një nga pjesëmarrësit në protestë, ka thënë për “Radion Evropa e Lirë (REL)” se familja duhet të largohet nga ai vend sepse, siç është shprehur ai, ajo është “përgjegjëse për ngasjen e pamatur të veturës” nga i dyshuari. Ai ka pretenduar se protestat nuk janë të motivuara etnikisht. “Në këto kushte, me këtë sjellje arrogante dhe mënyrën si sillen, mendoj se duhet të largohen. Ai (shoferi) është vetëm 20 vjeç dhe ngiste makinën me një patentë shoferi të Kosovës”, ka thënë Mlladenoviq. Ndërsa furrat e tij të bukës janë të rrethuara nga policia, gazetarja e “REL”-it nuk e ka gjetur pronarin e furrës në vendngjarje. Ai nuk i është përgjigjur as thirrjeve dhe as mesazheve të “REL”-it. Fushatës së përndjekjes dhe thirrjeve për dëbim u ka paraprirë gjuha e urrejtjes në një grup lokal në aplikacionin për dërgimin e mesazheve, “Viber”, anëtar i të cilit është edhe ministri në Qeverinë e

Serbisë, Novica Tonqev, ish-kryetar i komunës së Surdullicës. Edhe pse ka thënë se i mbështet demonstruesit, Tonqev për “REL”-in ka thënë ë se protestat nuk kanë “bazë kombëtare”. Sulmet dhe thirrjet për linçim i ka dënuar ministri për të Drejtat e Njeriut dhe të Pakicave, Demo Berisha, duke theksuar se është “e papranueshme që tragjedia të keqpërdoret për përhapjen e urrejtjes, thirrje për dëbim dhe dënim kolektiv mbi bazë të përkatësisë kombëtare”. “REL”-i nuk ka marrë përgjigje nga prokuroria kompetente nëse po heton sulmet dhe nxitjen e urrejtjes kombëtare në Surdullicë. Sipas regjistrimit të vitit 2022, në këtë qytet jetojnë gjithsej gjashtë qytetarë me kombësi shqiptare.

Në njërën anë protesta, e në tjetrën mbështetje

Policia, para protestës së fundit më 19 shkurt në Surdullicë, qëndronte para furrave të bukës “Park” në pronësi të familjes së shoferit të dyshuar, por demonstruesit, ndryshe nga herët e mëparshme, kësaj radhe nuk u mblodhën para tyre. Dhjetëra persona qëndronin në qendër të qytetit me flamuj të Serbisë dhe pankarta me mesazhin “Drejtësi për Rastkon” (i vdekur në aksident). Pavarësisht thirrjeve për bojkot dhe sulmeve, tri furrat në pronësi të familjes shqiptare vazhdojnë të punojnë. Një punonjëse në një nga furrat “Park”, e cila ka kërkuar të mos i zbulohet identiteti, ka thënë se nuk i mbështet protestat. Ajo ka thënë se për punëdhënësin e saj mund të thotë “vetëm fjalët më të mira”. Ndërsa gazetarja e “REL”-it po bisedonte me punonjësen, disa persona kanë hyrë në furrë për të blerë bukë, por nuk kanë pranuar të flasin. Në qendër të Surdullicës,

“REL”-i ka takuar edhe Danijellën, e cila ka theksuar se nuk e mbështet bojkotin e furrave dhe protestat. Ajo ka thënë se e njeh pronarin e furrës nga pamja dhe se është kundër përndjekjes së një familjeje të tërë. “Të përgjigjet ai që e ka kryer (veprën penale)”, ka thënë ajo. Prokuroria në Vlladiçin Han, pranë Surdullicës, ka njoftuar më 19 shkurt se për aksidentin rrugor janë duke u zhvilluar hetime për vepër të rëndë kundër sigurisë së trafikut publik, për shkak të vdekjes së një personi. Aksidenti ka ndodhur më 9 shkurt, ndërsa nga prokuroria kanë bërë me dije se i dyshuari B.F. posedon patentë shoferi nga Kosova “e cila iu mor menjëherë gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes nga policia”. Prokuroria ka njoftuar gjithashtu se do të urdhërojë ekspertizë “me qëllim që të përcaktohet shkaku i aksidentit, shpejtësia e lëvizjes së automjetit që drejtohej nga i dyshuari, si dhe fakti nëse personit të ndjerë iu ofrua ndihmë mjekësore në kohë”. Të dyshuarit i është caktuar masa e paraburgimit, ndërsa prokuroria ka theksuar se “në këtë, si në të gjitha procedurat, respektohet prezumimi i pafajësisë”. Prokuroria ka theksuar gjithashtu se këtë njoftim e ka lëshuar, ndër të tjera, për shkak të “publikimit të informacioneve të paverifikuara në rrjetet sociale”.

Si nisi?

Protestat në Surdullicë janë organizuar përmes rrjeteve sociale dhe aplikacionit për shkëmbim mesazhesh, “Viber”. Në rrjetet sociale dhe medie janë publikuar pjesë nga korrespondenca në grupin “Viber” - “Drejtësi për Rastkon”,

i cili është thënë se ka disa qindra anëtarë. Në këto komunikime, ndër të tjera, bëhet thirrje për bojkotimin e furrave, por edhe për dëbimin e familjes së të dyshuarit. Gjuha e urrejtjes ka përshkallëzuar në protesta, ku është sulmuar edhe gazetarja Dejana Cvetković, e cila po raportonte nga vendi i ngjarjes. “Në protestë u sulmova verbalisht dhe u pengova gjatë punës, më drejtonin komente të ndryshme me konotacion seksual. Mendoj se (disa individë) ishin të pakënaqur me raportimin tim, sepse i vendosa protestat në kontekstin e mosdurimit ndëretnik”, ka thënë ajo për “REL”-in. Ajo ka thënë se protesta e parë është organizuar para furrës së familjes së të dyshuarit, kur të pranishmit kanë hedhur vezë në drejtim të objektit. Cvetković ka thënë gjithashtu se në bisedë me pronarin e furrës ka mësuar se pas këtyre ngjarjeve ai ishte detyruar ta evakuonte familjen nga Surdullica, por se as kjo nuk ka kaluar pa incidente. “Ai më tha se protestuesit sulmuan automjetin që po evakuonte familjen e tij”, ka thënë ajo. “REL”-i nuk ka marrë informacion nga policia nëse dhe sa persona janë ndaluar për sulmet ndaj furrës dhe familjes shqiptare. Në të njëjtat protesta janë ormuluar edhe një sërë kërkesash drejtuar institucioneve, ku ndër të tjera kërkohet dorëheqja e drejtuesve të policisë në Surdullicë për shkak të pretendimeve për injorim shumëvjeçar të problemit të ngasjes së pamatur nga i dyshuari. Po ashtu, pyetje iu drejtuan edhe Qendrës Shëndetësore lokale për shkak të pretendimeve se ndihma e shpejtë ka mbërritur me vonesë. Autoritetet në Surdullicë nuk u janë përgjigjur pyetjeve të “REL”-it lidhur me protestat dhe

gjuhën e urrejtjes që u dëgjua në këto tubime.

Ministri “në krah të demonstruesve”

Një nga anëtarët e grupit “Viber” ku janë shkëmbyer mesazhe urrejtjeje ishte edhe ministri pa portofol në Qeverinë e Serbisë, Novica Tonqev, i cili është gjithashtu ish-kryetar i komunës së Surdullicës. I pyetur lidhur me thirrjet për dëbimin e familjes shqiptare, Tonqev është përgjigjur se në Surdullicë po mbahen “protesta paqësore si formë e shprehjes së pakënaqësisë për sjelljen e pamatur të pjesëmarrësve në trafik”. “Në këto tubime qytetare, shkaku nuk është aspak baza kombëtare, por vetëm adresimi ndaj institucioneve kompetente se gjëra të tilla dhe të ngjashme nuk duhet të ndodhin”, ka thënë ai.

Dënimi i shënjestrimit

Megjithatë, disa organizata joqeveritare dhe institucione në Serbi i interpretojnë ndryshe ngjarjet në Surdullicë. Organizata “Iniciativat Qytetare” ka njoftuar më 17 shkurt se në atë vend po zhvillohet një fushatë “që përfshin targetimin kolektiv të qytetarëve mbi bazë të përkatësisë së tyre kombëtare”. “Veçanërisht shqetësues është fakti se në kanalet e komunikimit ku u përhapën thirrjet për shpërngulje të përhershme dhe ndëshkim kolektiv kanë marrë pjesë edhe funksionarë publikë, përfshirë ministrin Novica Tonqev”, është thënë në reagim. Komisionari për Mbrojtjen e Barazisë, Millan Antonijević, ka dënuar kërcënimet dhe gjuhën e urrejtjes të drejtuar ndaj familjes me kombësi shqiptare. Antonijević ka deklaruar se shprehja publike e mesazheve që bëjnë thirrje për linçim, dëbim ose frikësim përbën shkelje serioze të së drejtës për barazi dhe mund të çojë në rrezikimin e sigurisë së qytetarëve dhe në përkeqësimin e marrëdhënieve ndëretnike. Së fundmi, për pozitën e pakicës shqiptare në Serbi ka paralajmëruar edhe Uashingtoni. Anëtarët e Komisionit për Politikë të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve të Kongresit amerikan në janar kërkuan shqyrtimin e një sërë problemesh me të cilat përballen shqiptarët në jug të Serbisë, duke vlerësuar se ata janë të diskriminuar. Qeveria në Serbi i ka hedhur poshtë këto vlerësime. Sipas regjistrimit të vitit 2022, në Serbi jetojnë më shumë se 60 000 shqiptarë dhe ata përbëjnë pakicën e katërt më të madhe kombëtare në vend.

KUVENDI MIRATON BUXHETIN E VITIT 2026 PAS KUNDËRSHTIMEVE NGA OPOZITA



Prishtinë, 20 shkurt - Kuvendi i Kosovës ka miratuar të premtën Ligjin për Buxhetin Shtetëror në vlerë rreth 4 miliardë euro pavarësisht prej kundërshtimeve dhe ankesave të opozitës. Projektligji për Buxhetin ka kaluar në lexim të dytë me 62 vota për, 36 kundër dhe asnjë abstenim, katër ditë pasi është miratuar në lexim të parë. Ligji tani do t'i dërgohet presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, për dekretim, para se të hyjë në fuqi. Votimi ka ardhur pasi Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere ka bërë ndryshime dhe i ka miratuar ato në Ligjin për Ndarjet Buxhetore për vitin 2026. Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka thënë se ky është një buxhet i "përkohshëm dhe emergjent", duke shtuar se ai do të rishikohet. "Për këtë arsye, ne si qeveri nuk ua kemi dhënë hapësirën as ministrive që të bëjnë ndryshime, duke konsideruar se nuk kemi shumë kohë për t'i bërë ndryshimet e nevojshme dhe në mënyrë

cilësore, në mënyrë që ato pastaj të mos reflektojnë me probleme gjatë rrugës", ka thënë Murati. Partitë opozitare janë ankuar se rekomandimet e tyre janë shpërfillur nga Komisioni për Buxhet dhe i kanë tërhequr ato në prag të votimit në Kuvend, prandaj edhe kanë votuar kundër kalimit të buxhetit vjetor. Deputetë të caktuar opozitarë paraqiten amendamente gjatë seancës, por nuk morën mbështetje. Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Arian Tahiri, ka kritikuar Projektligjin për Buxhetin dhe ka njoftuar se deputetët nga partia e tij do të votojnë kundër. "Ne i tërheqim të gjitha amendamentet dhe nuk e mbështesim këtë buxhet që nuk e reflekton as përbërjen e qeverisë, nuk është dokument profesional, ka shumë defekte për 2026-n, por do jetë i dëmshëm edhe për vitet e ardhshme", ka thënë ai në seancë. Ndërsa shefja e grupit parlamentar e LDK-së, Jehona

Lushaku, ka thënë se partia e saj nuk ka votë për buxhetin, pasi Komisioni për Buxhet nuk i ka marrë parasysh amendamente e propozuara nga ajo. Buxheti i vitit 2026 është miratuar me disa muaj vonesë, pas zgjatjes së buxhetit të vitit të kaluar për disa muaj për shkak të krizës politike dhe institucionale.

Si do të shpenzohet buxheti i vitit 2026?

Buxheti i vitit 2026 parashihet të arrijë në rreth 4 miliardë euro. Nga kjo shumë, mbi tre miliardë euro janë ndarë për nivelin qendror, ndërsa 867 milionë euro për nivelin lokal. Për investime kapitale, të cilat shihen si shtylla kryesore për zhvillimin ekonomik, janë planifikuar 998 milionë euro ose 7.2 për qind më shumë krahasuar me vitin 2025 (931 milionë euro). Megjithatë, investimet kapitale përbëjnë vetëm 25.2 për qind të buxhetit të përgjithshëm. Në një analizë

të Institutit GAP është thënë se 81 për qind e buxhetit të projekteve kapitale në vitin 2026 është për projektet që do të vazhdojnë nga vitet e kaluara, ndërsa projektet e reja mbeten të kufizuara si në numër ashtu edhe në vlerë dhe kryesisht janë projekte të vogla. Shpërndarja e investimeve kapitale, sipas GAP-it, nga niveli qendror në komuna vazhdon të jetë joproporcionale me popullsinë dhe sipërfaqen, ndonëse më e balancuar nga aspekti partiak, duke nxjerrë në pah pabarazi.

Subvencionet dhe transferet

Kategoria me rritjen më të madhe është ajo e subvencioneve dhe transfereve, me një rritje prej 17.4-përqindësh. Sivjet janë ndarë mbi 1.3 miliard euro krahasuar me rreth 1.1 miliard euro në vitin e kaluar. Kjo rritje vjen si rezultat i rritjes së disa kategorive të pensioneve, mbështetjes së

lehonave dhe rritjes së asistencës sociale. Pagat dhe shtesat për mbi 91 mijë punonjës të sektorit publik do të kushtojnë mbi 980 milionë euro, nga 916 milionë euro sa ishin në vitin 2025. Ndërkohë, shpenzimet për mallra dhe shërbime arrijnë në 509 milionë euro, ose rreth 7 milionë euro më shumë se vitin e kaluar. Në buxhet janë ndarë edhe 46 milionë euro si rezervë shtetërore për emergjencë, e njëjta shumë si në vitin paraprak, me qëllim ruajtjen e stabilitetit dhe likuiditetit financiar. Për herë të parë projektbuxheti parasheh edhe pagën e 13 për punonjësit e sektorit publik, për ata që kanë qenë të angazhuar në organizata buxhetore të paktën 12 muaj para marrjes së vendimit. E barrën kryesore për mbushjen e arkës së shtetit pritet ta mbajë Dogana e Kosovës, nga e cila parashihet të grumbullohen mbi dy miliardë euro, por edhe Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), me rreth 1.2 miliard euro të hyra të planifikuara.

Ministria e Mbrojtjes shpall konkurs për rekrutimin e 320 ushtarëve të rinj në FSK

PRISHTINË, 20 SHKURT - Ministria e Mbrojtjes ka shpallur konkurs për rekrutimin e ushtarëve të rinj në Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK). Sipas këtij konkursi, janë planifikuar të rekrutohen 320 ushtarë të rinj. Afati për

aplikim do të jetë nga 2 deri më 27 mars të këtij viti. Të drejtë aplikimi kanë shtetasit e Kosovës nga moshë 18 deri në 25 vjeç të cilët kanë përfunduar shkollimin e mesëm. Kandidatët duhet t'i plotësojnë edhe këto kritere shtesë:

gjendje të mirë fizike dhe shëndetësore, figurë e pastër morale dhe ligjore si dhe përkushtim për të shërbyer me dinjitet dhe profesionalizëm. "Aplikimi bëhet përmes: <https://rekrutimi.fsk-ks.org>", ka njoftuar FSK-ja.



INFLACIONI AGRESIV NË KOSOVË, NORMA VJETORE NË JANAR ARRIN NË 5.8 PËR QIND



PRISHTINË, 20 SHKURT - Të dhënat e Agjencisë të Statistikave të Kosovës, të publikuara këto ditë për çmimet e konsumit për muajin janar 2026 dhe norma vjetore e inflacionit që ka arritur në 5.8 për qind, tregojnë se niveli kaq i lartë i inflacionit është përtej të gjitha parashikimeve, edhe atyre optimiste edhe pesimiste. Norma vjetore e inflacionit, enorme e lartë, e arritur në fund të janarit, është përtej çdo parashikimi edhe institucional edhe të njohësve të zhvillimeve të ecurive të çmimeve në vend. Sepse të dhënat e Agjencisë të Statistikave të Kosovës (ASK), të publikuara këto ditë për çmimet e konsumit për muajin janar 2026, në bazë të të cilave nënkuptohet se norma vjetore e inflacionit ka arritur në 5.8 %, tregojnë se niveli kaq i lartë i inflacionit është përtej të gjitha parashikimeve. Siç dihet, për vitin 2026 Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka parashikuar që inflacioni të jetë 3.4 për qind, ndërsa norma e arritur në fund të janarit 2026, në bazë të të dhënave të ASK-së, po del të jetë përafërsisht dyfish më shumë. Dhe, ç'është më keq, në bazë të zhvillimeve në sektorin e çmimeve në Kosovë në muajin e parë të këtij viti, rritjes jashtë çdo logjike ekonomike dhe financiare të çmimeve, sidomos të

produkteve të shportës dhe tendencave të pafshehura të tregtarëve për ta vazhduar trendin e ngritjes së egër dhe brutale të çmimeve, as ekspertët nuk e kanë idenë se ku do të ndalet niveli i inflacionit në muajt në vazhdim dhe fare në fund të vitit, raporton "Buletini Ekonomik". Ndërkohë çmimet e konsumit në fund të janarit, në bazë të të dhënave të ASK-së, dalin të jenë goxha më të larta se çmimet e konsumit në Kosovë më 2025, kur ishte shënuar rritje e çmimeve për 3.9 krahasuar me vitin 2024. Ndërsa, sipas statistikave, çmimet në dhjetorin e vitit që shkoi ishin për 5.3 % më të larta sesa në dhjetorin e 2024-s. Sipas raportit të ASK-së, kjo kryesisht është shpjeguar "me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë të pemët (19 për qind), energjia elektrike (18.3 për qind), shërbime të tjera në lidhje me pajisjet personale të transportit (18.1 për qind), mirëmbajtja dhe riparimi i pajisjeve personale të transportit (14.7 për qind), mishi (14.4 për qind), pushime të organizuara (13.5 për qind), lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (13.1 për qind), kaffja, çaji dhe kakao (11.9 për qind), qumështi, djathi dhe vezët (9.8 për qind)..."

Por, çmimet në Kosovë vazhdojnë të rriten goxha hovshëm edhe në muajt e parë të këtij viti. Sipas të dhënave të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), shkalla vjetore e inflacionit në muajin janar 2026 ka arritur në 5.8 për qind krahasuar me janarin e vitit 2025, ndërsa inflacioni mujor (krahasuar me dhjetorin 2025) ishte 1.2 për qind. Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit (IHÇK) shënoi rritje në janar për shkak të ngritjes së ndjeshme të çmimeve në disa grupe të konsumit sipas klasifikimit të COICOP-it. Në periudhën janar 2026/janar 2025 rritja më e madhe e çmimeve është regjistruar te biletat e fluturimeve (+50.4 për qind), te furnizimi me ujë dhe te shërbimet komunale (+44.4 për qind), te lëndët djegëse – dru zjarri, pelet etj. (+17.2 për qind), energjia elektrike (+16.7 për qind), pemët (+15.5 për qind), mirëmbajtja e automjeteve (+15.1 për qind), (shërbimet e transportit personal (+14.5 për qind), pushimet e organizuara (+13.5 për qind), mishi (+13.1 për qind), kafe, çaj dhe kakao (+10.3 për qind). Ndërsa rritje më të moderuar kanë shënuar edhe qumështi, djathi dhe vezët (+8.7 për qind), shërbimet hoteliere (+8.6 për qind), pijet

alkoolike (+6.5 për qind), mish i peshkut (+6.1 për qind), bukë dhe drithërat (+4.9 për qind) etj. Veshjet dhe këpucët (+2.7 për qind) Në total, ndikimi i këtyre ngritjeve në IHÇK vlerësohet në +6.2 për qind. Nga ana tjetër, rënia më e theksuar e çmimeve është regjistruar te karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal, me -7.3 për qind që ka ndikuar negativisht në IHÇK me rreth -0.4 për qind. Energjia elektrike, kafeja, pemët dhe mishi janë ndër produktet që pësuan rritjen më të madhe të çmimeve gjatë vitit 2025. Ndërsa në janar të 2026-s ka lënë gjurmë në rënieën e fuqisë financiare të qytetarëve ngritja e çmimit të ujit të pijshëm dhe të shumë produkteve ushqimore, ndër to të mishit. Sipas ASK-së, ndryshimet e çmimeve janë reflektuar pothuajse në të gjitha grupet e konsumit, por më së shumti në transport, ushqim dhe energji, kategori që kanë ndikimin më të madh në buxhetin e familjeve. Ndërkohë, vrojtes të vëmendshëm të zhvillimeve në sektorin e çmimeve kanë thënë për "Buletinin Ekonomik", se në buxhetin familjar, respektivisht në varfërimin e kosovarëve si rrjedhojë e rënies së fuqisë blerëse të tyre nga çmimet enorme të larta të ngritura,

ndikim të madh vazhdojnë të kenë çmimi i ngritur i energjisë elektrike me rreth 17 për qind e përtej në vitin e kaluar, por edhe çmimi i ngritur brutalisht i ujit të pijshëm dhe trajtimi i ujërave që nga 1 janari 2026 për rreth 40 për qind. ASK-ja në fund të janarit 2026, kur ka vlerësuar kategoritë e konsumit me ndikim më të madh në rritjen e çmimeve, nuk ka pasur mundësi t'i veçojë edhe disa produkte të tjera mese çmime pakuptueshëm të ngritura, për shkak se çmimet e tyre të hovshme kanë ndodhur suksesivisht gjatë tërë janarit, madje edhe shkurtit, siç ka ndodhur me çmimin e mishit, të shënuar këtyre ditëve në prag të muajit të shenjtë të myslimanëve, Ramazanit. Edhe paralajmërimi i ringritjes së çmimit të energjisë elektrike, tarifave të reja në fund të marsit, ka ndikuar ndjeshëm te shumë prodhues dhe tregtarë për ngritjen e çmimeve dhe në paralajmërimin për çmime të reja të ngritura. Në këtë mënyrë, në Kosovë, në këto rrethana të "çmimeve në rënie të lirë" dhe praktikisht jashtë kontrollit institucional, nuk dihet ku do të përfundojë norma e inflacionit. Tani për tani inflacioni në Kosovë është ndjeshëm më i larti ndër shtetet e rajonit dhe ato të Evropës.

KURTI: LIGJET PËR BYRONË SHTETËRORE DHE ÇMIMET TAVAN, PRIORITETE TË QEVERISË



PRISHTINË, 20 MARS - Qeveria e Kosovës ka miratuar të premten një program legjislativ dyvjeçar, i cili përfshin dy ligje të rëndësishme: atë për Byronë Shtetërore për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme dhe Ligjin për Çmimet Tavan. Duke folur në mbledhje të qeverisë, kryeministri Albin Kurti ka thënë se këto dy ligje janë prioritet i tij në dy vjetët e ardhshme. “Do të vazhdojmë me vendosmëri për të sjellë ligje të qarta e cilësore në dobi të qytetarëve dhe sundimit të ligjit”, ka thënë Kurti. Kjo është një përpjekje e re e Kurtit për t'i fuqizuar këto ligje, pasi Gjykata Kushtetuese ia kishte rrëzuar që të dyja gjatë mandatit të kaluar katërvjeçar. Programi legjislativ është lista

zyrtare e projektligjeve që qeveria synon t'i hartojë dhe t'i dërgojë për miratim në Kuvend brenda një periudhe të caktuar. Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, ka njoftuar se e ka nënshkruar nisjen e procedurës për projektligjin për masat e përkohshme të produkteve themelore në rast të krizave ekonomike (Ligji për Çmimet Tavan). Ajo ka thënë se ky projektligj krijon bazën ligjore për ndërhyrje të shpejtë dhe të drejtë kur vendi përballet me rritje të papritura të çmimeve, mungesë të produkteve themelore dhe çrregullime në furnizim. “Qëllimi nuk është ndërhyrja arbitrare në treg, por mbrojtja e qytetarëve nga

abuzimi dhe spekulimi në kohë krize. Masat janë të përkohshme, proporcionale dhe të orientuara drejt ruajtjes së stabilitetit ekonomik”, ka thënë Kusari-Lila.

Ligji për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme

Gjykata Kushtetuese ia kishte rrëzuar Kurtit dy herë Ligjin për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, së pari më 2024, pastaj në fillim të këtij viti. Ky ligj synon që të gjithë zyrtarët publikë në Kosovë të jenë subjekt i verifikimit të pasurisë nëse ka dyshime se ajo është fituar në mënyrë të kundërligjshme.

Kushtetuesja kishte thënë në vendimin e janarit se e ka shfuqizuar Ligjin për Byronë sepse ai ishte miratuar me “shkelje të rënda procedurale dhe kushtetuese”. Sipas saj, Kuvendi e ka përdorur në mënyrë të pajustificuar shmangien nga afatet procedurale, duke mos u dhënë deputetëve dhe komisioneve kohë për shqyrtim, debat dhe amendamente, në kundërshtim me nenet 74, 76 dhe 77 të Kushtetutës.

Ligji për Çmimet Tavan

Ligji për Çmimet Tavan ishte shpallur i pavlefshëm nga Gjykata Kushtetuese në vitin 2023. Asokohe gjykata kishte

theksuar se ai nuk ishte në përputhje me Kushtetutën e vendit. Qeveria e kishte arsyetuar ligjin për shkak të “ritjes së paarsyeshme të çmimeve bazë dhe ankesave të shumta të qytetarëve lidhur me rritjen e menjëhershme të çmimeve të të gjitha produkteve bazë”. Sipas qeverisë, ligji do të aplikohet në raste të veçanta të destabilizimit në treg. Ligji, tashmë i shpallur i pavlefshëm, i konsideronte produkte themelore drithërat, bukën, miellin, orizin, pastat, vajin ushqimor të lulediellit, qumështin, kripën e kuzhinës, vezët e pulës, mishin e pulës, sheqerin kristalor, produktet e higjienës personale dhe lëndët e drurit për djegie.


AUV-i asgjëson rreth 8 000 produkte ushqimore për fëmijë

PRISHTINË, 20 SHKURT - Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) ka njoftuar se në bashkëpunim me kompaninë “UNION shpk” ka asgjësuar 7 998 copë produkte ushqimore për fëmijë, me peshë totale prej 4 130.80 kilogramë, të markave “Aptamil” dhe “Nutricia Bebelac”. Sasia e asgjësuar është përzgjedhur sipas datave të skadencës, në përputhje me njoftimet e pranuar nga Njësia e

Alarmit të Shpejtë për Ushqim dhe Ushqim për Kafshë (RASFF). “Ne jemi duke verifikuar dhe gjurmuar nëse ndonjë sasi e këtyre produkteve ka mbetur ende në treg, për të garantuar që konsumatorët të mos ekspozohen ndaj rrezikut”, ka njoftuar AUV-i. Agjencia ka theksuar e mbetet e përkushtuar për monitorimin e vazhdueshëm të tregut dhe

zbatimin e masave parandaluese dhe kontrolluese. “Qëllimi ynë kryesor është garantimi i sigurisë ushqimore dhe mbrojtja e shëndetit të konsumatorëve në Republikën e Kosovës. Ky veprim vjen si pjesë e angazhimit institucional për të parandaluar rreziqet që mund të shkaktojnë produktet ushqimore të skaduar ose të pasigurta për fëmijët”, ka njoftuar AUV-i.





**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Lëndohet mbrojtësi sllovak, humb ndeshjen me Kosovën

STAMBOLL, 20 SHKURT - Fenerbahçe ka njoftuar se kapiteni Milan Skriniar ka pasur këputje të pjesshme të muskulit në ndeshjen ndaj Nottingham Forestit të enjten mbrëma, që ishte e para e plejofit të Ligës së Evropës. Fenerbahçe është

mposhtur 3:0 në shtëpi, ndërsa qendërmbrojtësi sllovak është zëvendësuar në minutën e 26. Ai pritet ta humbë edhe duelin e gjysmëfinale të "play-off"-it të Botërorit 2026 me Sllovakinë ndaj Kosovës, që luhet më 26 mars në Bratislavë. Kështu kanë

shkruar mediet turke të premten. "Incizime të detajuara janë bërë në kapitenin Milan Skriniar pas lëndimit që e pësoi ndaj Nottinghamit të enjten mbrëma. Ai ka pasur këputje të pjesshme të muskulit në kofshën e këmbës së djathtë dhe

ka nisur rikuperimin", ka shkruar Fenerbahçe. Skriniar në këtë edicion i ka zhvilluar 35 ndeshje dhe ka kontribuar me dy gola e një asistim për skuadrën turke. Ndërkohë me Sllovakinë i ka 87 paraqitje dhe tri gola të shënuar.



HIDHET SHORTI PËR ÇEREKFINALET E KUPËS SË KOSOVËS, DUELE DIREKTE DHE SFIDA PA FAVORIT TË QARTË

PRISHTINË, 20 SHKURT - Kupa e Kosovës ka hyrë në fazën vendimtare, me katër përballje interesante që premtjnë rivalitet, emocione dhe luftë për gjysmëfinale. Federata e Futbollit të Kosovës ka zyrtarizuar të premten çiftet e çerekfinaleve të Kupës së Kosovës, duke sjellë përballje të forta mes skuadrave të Superligës dhe atyre që kërkojnë befasi në këtë fazë të garës. Vëmendja kryesore pritet të jetë në Suharekë, ku Ballkani përballlet me Gjilani. Një duel mes dy emrave të mëdhenj të futbollit të Kosovës, që premtion intensitet, cilësi dhe emocione deri në vërshtëllimën

e fundit. Në Podujevë, Llapi pret Malishevën. Vendasit synojnë ta shfrytëzojnë përvojën dhe terrenin e tyre, ndërsa mysafirët vijnë me ambicie të qarta për ta vazhduar rrugëtimin në Kupë. Në Klinë, Dukagjini do të përballlet me Feronikelin '74, në një duel ku të dy ekipet synojnë historinë. Një ndeshje e hapur, ku detajet pritet ta bëjnë dallimin dhe ku kualifikimi mbetet i paparashikueshëm. Një tjetër përballje interesante zhvillohet mes Ferizajt dhe Vushtrrisë, ku përballen dy skuadra me objektiva të ndryshme, por me të njëjtin



synim: kalimin në gjysmëfinale. Me këto çifte, Kupa e Kosovës konfirmon edhe një herë se është garë e befasive. Çdo ndeshje është finale më vete, ndërsa katër skuadrat fituese do të sigurojnë një vend në gjysmëfinale dhe një hap më afër trofeut.

ÇIFTET ÇEREKFINALE TË KUPËS SË KOSOVËS:

Dukagjini - Feronikeli 74'
Llapi - Malisheva
Ferizaj - Vushtrria
Ballkani - Gjilani

DRITA MPOSHTET NGA CELJE NË "FADIL VOKRRI", GJITHÇKA VENDOSSET NË NDESHJEN E KTHIMIT



PRISHTINË, 20 SHKURT - Kampionia e Kosovës, Drita, është mposhtur me rezultat 3:2 nga skuadra sllovene, Celje, në ndeshjen e parë të "play-off"-it të fazës nokaut të Ligës së Kombeve, që është zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë, në prani të një numri simbolik të tifozëve. Ndonëse skuadra gjilanasë ka arritur të rikthehet nga disavantazhi prej dy golave dhe ta barazonte rezultatin në 2:2, mysafirët kanë realizuar golin e fitores në minutën e katërt shtesë (94').

Celje ka kaluar në epërsi në minutën e 19 me golin e Armandas Kuçys, ndërsa avantazhin e ka dyfishuar Milot Avdyli për 2:0. Para këtyre golave, Drita ka pasur dy mundësi të mira shënimi me Kristal Abazajn (6') dhe Albert Dabiqajn (10'), por pa arritur ta gjejë golin. Trajneri i Dritës, Zekirija Ramadani, ka reaguar në pjesën e dytë me inkuadrimitin e Blerim Krasniqit dhe Liridon Balajt, vendim që ka rezultuar i qëlluar. Krasniqi ka ngushtuar epërsinë

në 2:1 në minutën e 59, pas asistimit nga Balaj, ndërsa ky i fundit ka realizuar vetë në minutën e 75-të për 2:2, duke rikthyer shpresat e kampiones së Kosovës. Megjithatë, në çastet e fundit të takimit, Matej Poplatnik ka realizuar për 3:2 me gjuajtje me kokë, duke i siguruar Celjes një avantazh minimal para ndeshjes së kthimit, që do të zhvillohet më 26 shkurt. Drita mbetet në garë për kualifikim, pasi rezultati i ngushtë lë hapësirë reale për përmbysje në transfertë.

Ancelotti pritet ta rinovojë kontratën me Brazilin

BRASILIA, 20 SHKURT - Trajneri italian Carlo Ancelotti është duke shijuar maksimalisht aventurën e tij me "Seleção" dhe ka deklaruar se pret ta "zgjasë kontratën edhe për katër vite të tjera" me përfaqësuesen e Brazilit. Ish-trajneri i Milan, Juventus, Chelsea, Bayern Munich, Real Madrid dhe Paris Saint-Germain, ka

marrë detyrën e tij të parë në nivel kombëtarësh kur është emëruar nga Brazili verën e kaluar. Madje përpara se të përballlet me sfidat e para të mëdha në kuadër të Kupës së Botës 2026, që do të zhvillohet në ShBA, Meksikë dhe Kanada, ai tashmë po mendon për të ardhmen. "Është një lloj i ri pune për mua, dhe singlerisht jam

ndikuar shumë pozitivisht nga kjo eksperiencë. Mendoj se do ta rinovoj kontratën me Brazilin edhe për katër vite të tjera", ka deklaruar Ancelotti për "Movistar". Plani, sipas tij, është të ndërtohet një projekt afatgjatë, me synim jo vetëm Kupën e Botës 2026, por edhe Kupën e Botës 2030 dhe Kupën e Amerikës 2028.

66-vjeçari ka regjistruar dy fitore, një barazim dhe një humbje që prej nënshkrimit të kontratës në maj 2025. Shumë tifozë kishin shpresuar që ai të linte drejtimin e Brazilit dhe një ditë të merrte në dorë kombëtaren e vendit të tij, Italinë, e cila ka hasur vështirësi nën drejtimin e disa përzgjedhësve dhe ka



munguar në dy edicione radhazi të Kupës së Botës.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

CjeJ Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë





www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT




SWISS

TAVERNA



Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553



Lumë's Details

Estetik & Depilim



 044 900 978 | 045 681 898

 Sallon Depilimi Lumë's Details

 lumesdetails

 Abrrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Aktes Group” SH.P.K. pronar Abubekir Kavurmaci me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812254564 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Aktes Group” D.O.O. Abubekir Kavurmaci Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812254564 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Aktes Group” L.L.C. with owner Abubekir Kavurmaci with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 812254564 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ardian Shabani shpall te pavlefshme dëftesat e vitit I,II,III te shkolles se mesme të Lartë “Dr, Xheladin Deda”.

- Asllan Babaj shpall te pavlefshme dëftesat e vitit I,II,III dhe diplomën e shkolles së mesme të larte të gjimnazi “Frang Bardhi”.

- Doni ES Sh.p.k. shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me numër unik identifikues 811273507.

- Florentina Trepça shpall te pavlefshme diplomën e shkolles së mesme të lartë “Dr, Xheladin Deda”.

- Sami Mustafa shpall te pavlefshme dëftesën e shkolles fillore “Fehmi Rama” ish shkolla fillore “Emin Duraku” Likoc Skenderaj.

- Hysen Ferizi shpall te pavlefshme dëftesën e shkolles fillore “Azem Bejta” Prekaz i Eperm Skenderaj.

- Rustem Tahiri shpall te pavlefshme dëftesën e shkolles fillore “Trepça” Stanterg.

- Drita Zabeli shpall te pavlefshme dëftesën e shkolles fillore “Malush Ahmeti” ish shkolla “Muharrem Bekteshi” Rezalle Skenderaj.

Milaim Sh. Hajdari shpall të pavlefshme diplomën e shkolles së mesme Teknike mekanik i radiotelevizionit të shkolles “Gjin Gazulli” Prishtinë.

Kujtim Hakaj shpall të pavlefshme diplomën e sh, profesionale “Dituria” Prizren.

Tahir Neziri shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Kuvendi i Juniku” Junik.

Zejnije Morina shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Xhelal Hajda Toni” Ratkoc Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkolles Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

